



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"  
SENATI AKADEMIK

Nr. 1092/5 Prot.

Gjirokastrë, më 08 / 09 /2020

**RREGULLORE PËR ORGANIZIMIN DHE PUNËN E  
NJËSISË SË SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË**

**UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTER**



(Miratuar me Vendimin nr. 26, datë 08 / 09 /2020, të Senatit Akademik të UGJ-së

## **Neni 1**

### **Objekti**

Kjo rregullore ka për qëllim rregullimin e veprimtarisë së Njesisë së Brendshme të Sigurimit të Cilësisë në Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokastër, në përputhje me objektivat dhe misionin ligjor të institucionit.

## **Neni 2**

### **Baza ligjore**

Ligji i Arsimit të Lartë, aktet nënligjore të dala në zbatim të tij, Statuti dhe Rregullorja e UGJ-së, janë baza ligjore e kësaj Rregulloreje.

## **Neni 3**

### **Misioni i NJSBC**

Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC), është strukturë përgjegjëse për hartimin e politikave dhe procedurave për sigurimin e brendshëm të cilësisë, impementimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm të sistemit të cilësisë në UGJ., mbështetur në standartet shtetërore të cilësisë (Kodin e Cilësisë në Arsimin e Lartë) dhe udhëzimet europiane për sigurimin e cilësisë në Hapësirën Europiane të Arsimit të Lartë.

Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë është strukturë më vete paralele nga sektori i standarteve dhe i kurrikulave e ngritur pranë Rektoratit të UGJ-së me përfaqësues nga çdo njësi kryesore.

## **Neni 4**

### **Struktura e NJSBC**

Njësia e sigurimit të Brendshëm të Cilësisë është strukturë pranë Rektoratit. Ajo përbëhet nga 7 (shtatë) anëtarë, 4 (katër) anëtarë janë përfaqësues të personelit akademik të njësive kryesore, 2 (dy) përfaqësues administrativ (zyra e kurrikulave dhe kërkimi shkencor) 1 (një) përfaqësues studentor.

## **Neni 5**

### **Objekti i veprimtarisë së NJSBC**

Misioni i kësaj njësie është të garantojë zbatimin e procedurave të aprovuara nga organet drejtuese nëpërmjet kontrollit dhe vlerësimit të procesit mësimor në aspektin mësimdhënies.

Njësia e Sigurimit të Cilësisë realizon funksionet e saj nëpërmetj metodate të vlerësimit dhe vetëvlerësimit duke bërë të mundur përmirësimin dhe rritjen e cilësisë së brendshme në institucion.

NJSBC kryen funksionet e mëposhtme:

1. Koordinon veprimtarinë e sigurimit të cilësisë në njësinë kryesore duke u shtrirë në çdo program studimi dhe kërkimi shkencor të ofruar;
2. Planifikon organizimin periodik të vlerësimit të brendshëm të cilësisë të programeve të studimit në njësitë kryesore;



3. Në bashkëpunim me zv/ Rektorin për procesin mësimor, Dekanët dhe Sektorin e Standarteve dhe Kurrikulave harton planin vjetor të veprimit për përmirësimin e cilësisë dhe harton raportin vjetor të cilësisë;
4. Mban lidhje të vazhdueshme me ASCAL për zhvillimin e proceseve të parashikuara në kornizën ligjore në fuqi,
5. Siguron vijueshmërinë periodike dhe të përvitshme të programit të Sigurimit të Cilësisë.
6. Lehtëson dhe inkurajon stafin akademik në procesin e mësimdhënies dhe vlerësimit.
7. Administron të dhëna statistikore me qëllim ruajtjen dhe përmirësimin e cilësisë.
8. Merr drejtimin në përgatitjen e dokumenteve për qëllime të jashtme : si akreditimet, bashkëpunimet me ASCAL.
9. Asiston Dekanët dhe Fakultetet në zhvillimin dhe vënien në jetë të procedurave për verifikimin dhe përmirësimin e cilësisë.

#### **Neni 6**

##### **Kurrikulat**

Përmirësimi i vazhdueshëm i kurrikulave, që ka për qëllim rritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies, realizohet në zbatim të strategjisë së institucionit dhe akteve juridike në fuqi. Njësia e sigurimit të brendshëm të cilësisë ndjek dhe kontrollon zbatimin e procedurave që zbatohen nga dekanati , departamenti për ndryshimet në syllabuset dhe programet e studimeve të miratuara.

#### **Neni 7**

##### **Vlerësimi i cilësisë së programeve të studimit dhe kërkimit shkencor**

1. Vlerësimi i brendshëm i programeve të studimit dhe kërkimit shkencor apo institucional, realizohet në përputhje me udhëzimet përkatëse të ASCAL.
2. Për vlerësimin e brendshëm të programeve të studimit dhe kërkimit shkencor apo vlerësimit të brendshëm institucional, ngrihet grupi i vlerësimit të brendshëm, ku merr pjesë edhe një përfaqësues nga studentët. Grupi i vlerësimit të brendshëm ngrihet nga Dekani i njësisë kryesore që mbulon atë program studimi . Grupi i vlerësimit të brendshëm ka akses në të gjitha të dhënat e institucionit.
3. Përfundimet e vlerësimit të brendshëm mbështeten në analizën statistikore të të dhënave, në konstatimet e nxjerra nga regjistrat, në sondazhet, pyetësorët me stafin akademik, studentët të lidhur me programin e studimit apo institucionin.
4. Vlerësimi i jashtëm i cilësisë dhe akreditimi kryhen në përputhje me kornizën ligjore në fuqi dhe Kodin e Cilësisë në Arsimin e Lartë.

